

VENDIM
Nr. 233, datë 1.4.2026

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 643, DATË 5.10.2022, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES DHE TË MËNYRËS SË
FUNKSIONIMIT TË KOMITETIT PËR PLANIFIKIMIN KOMBËTAR SPITALOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 6, të ligjit nr. 55/2022, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 1, e vendimit nr .643, datë 5.10.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e përbërjes dhe të mënyrës së funksionimit të Komitetit për Planifikimin Kombëtar Spitalor”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Përcaktimin e përbërjes dhe të mënyrës së funksionimit të Komitetit për Planifikimin Kombëtar Spitalor, si organ këshillimor pranë ministrit përgjegjës për shëndetësinë, me 9 (nëntë) anëtarë, si më poshtë vijon:

- Prof. Alban Dibra, mjek kardiolog;
- Prof. Roland Bani, mjek familjeje;
- Prof. Alketa Qosja, mjek neonatologe;
- Prof. Altin Veshti, mjek kardiokirurg;
- Prof. Arben Rroji, mjek radiolog;
- Prof. Helidon Nina, mjek kirurg onkolog;
- Dr. Leon Kaza, mjek gjinekolog;
- Dr. Skënder Brataj, mjek urgjence;
- Znj. Rudina Degjoni, ekonomiste.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama